



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 3, datë 27.01.2022**

**MBI**

**“NJOFTIMIN ZYRTAR TË SIPËRMARRËSIT ONE TELECOMMUNICATIONS SH.A.  
PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS AKSIONARE TË SHOQËRISË TREGTARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi Frashëri	Kryetar
2. Znj. Ketrin Topçiu	Anëtare
3. Znj. Xhoana Lilaj	Anëtare
4. Z. Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 27.01.2022, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***“Njoftimin zyrtar të sipërmarrësit One Telecommunications Sh.a. për ndryshimin e strukturës aksionare të shoqërisë tregtare”***

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 6, neni 8, pika 1 dhe 3 e nenit 114, pika 1 e nenit 115 të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH, i ndryshuar” (**Ligji nr. 9918/2008**);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr.44/2015**)
3. Pika 4, neni 7, i Rregullores nr. 30, datë 05.12.2013 “Për per dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr.30/2013**).

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Njoftimi i sipërmarrësit OneTelecommunications Sh.a. për ndryshimin e strukturës së aksionarëve, protokolluar në AKEP me nr.73, datë 21/01/2022;
2. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projekt vendimit (**Relacioni**);
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike “*One Telecommunications*” Sh.a nëpërmjet shkresës zyrtare (pjesë e praktikës dokumentare) ka njoftuar Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare mbi ndryshimin e strukturës së aksionarëve në favor të shoqërisë hungareze “*4iG*”. Bazuar në marrëveshjen e shitjes dhe të blerjes (SPA) blerësi përfiton 100% të aksioneve të zotëruara nga shitësi “*Albania Invest*”. Nëpërmjet këtij transaksioni, shoqëria blerëse përfiton kontrollin mbi shoqërinë “*One Telecommunications*” Sh.a.
2. Këshilli Drejtues i AKEP ka marrë në vlerësim njoftimin e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “*One Telecommunications*” Sh.a., në referim me legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e komunikimeve elektronike, si dhe nën dritën e vendimmarrjes së fundit të AKEP për rastet e kalimit të pronësisë apo ndryshimit të strukturave aksionare të shoqërive që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike të pajisur me Autorizim Individual për përdorimin civil të spektrit të frekuencave.
3. AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1, datë 10.01.2022 ka unifikuar qëndrimin sa i përket *ratio legis* të nenit 71 dhe 74 të Ligjit nr.9918/2008, mbi dhënien e miratimit paraprak për rastet e transferimit të së drejtës së përdorimit të Autorizimeve Individuale nga sipërmarrësi mbajtës i kësaj të drejte tek një sipërmarrës tjetër. Në këtë kuptim, duke mbajtur në vëmendje gjithashtu dhe parashikimin ligjor të dhënë në nenet 6 dhe 8 të Ligjit nr. 9918/2008, në të cilat parashikohet se AKEP është autoriteti i vetëm rregullator përgjegjës për mbikqyrjen dhe kontrollin e sektorit të komunikimeve elektronike si dhe lëshon Autorizime Individuale për përdorimin e brezave të frekuencave sipas Planit Kombëtar të Frekuencave, kompetenca institucionale e tij në çështjen objekt shqyrtimit kufizohet në ushtrimin e veprimtarisë administrative për kryerjen e ndryshimeve të pronarëve apo përfaqësuesve ligjorë në Njoftimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe në Autorizimet Individuale që mbahen nga sipërmarrësi “*One Telecommunications*” Sh.a.
4. Në rastin objekt shqyrtimi, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon se nuk jemi përpara momentit procedural të transferimit të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave, pasi nga sipërmarrësi “*One Telecommunications*” Sh.a. nuk kërkohet transferimi i të gjitha apo i një Autorizimi Individual që ka në përdorim, por bëhet me dije ndryshimi i strukturës aksionare. Përfundimi i kontrollit të shoqërisë nga shoqëria blerëse nëpërmjet ndryshimit të strukturës aksionare, nuk përfshin procesin e transferimit të së drejtës për përdorimin e frekuencave nga një sipërmarrës tek një tjetër dhe për rrjedhojë, shoqëria “*One Telecommunications*” Sh.a. do të vijojë të jetë mbajtës i Autorizimeve Individuale të lëshuara nga AKEP për qëllime të përmbushjes së aktivitetit të saj tregtar.

Megjithëse shoqëria blerëse “4iG” është po ashtu edhe shoqëri aksionere e sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a, këta dy sipërmarrës nuk kanë njoftuar për transferime të Autorizimeve Individuale, por vetëm për ndryshime të strukturës aksionere të shoqërive, të cilat nuk ndikojnë në detyrimet e sipërmarrësve kundrejt organit rregullator.

5. Mbështetur në referimin ligjor si më sipër, AKEP ka parashikuar në pikën 4, të nenit 7 të Rregullores nr.30/2013, detyrimin e sipërmarrësve për të njoftuar çdo ndryshim në pronësinë apo strukturën aksionare me qëllim reflektimin e tyre në Njoftimin e Autorizimit të Përgjithshëm, dhe në Autorizimet Individuale që kanë në përdorim.
6. Këshilli Drejtues i AKEP, duke pasur në vëmendje se mbetet në kompetencë të Autoritetit të Konkurrencës, si institucion përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës efektive, vlerësimi apo verifikimi nëse marrëveshja e lidhur midis dy shoqërive paraqet kushtet apo riskun e kufizimit apo dëmtimit të konkurrencës në treg, thekson se ndryshimet përkatëse në autorizimet e lëshuara nga AKEP do të reflektohen vetëm pas dhënies së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës për kryerjen e këtij transaksioni dhe pasqyrimin të këtyre ndryshimeve në Qendrën Kombëtare të Bisnesit .

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në pikën 1, të nenit 114, pikën 1, të nenit 115, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore të cituara në këtë Vendim, Këshilli Drejtues i AKEP:

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë qëndrimin e AKEP lidhur me njoftimin zyrtar të sipërmarrësit “One Telecommunications” Sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve për reflektimin e ndryshimeve në Rregjistrin e Sipërmarrësve, Njoftimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe Autorizimeve Individuale të sipërmarrësit “One Telecommunications” Sh.a., pas pasqyrimin të ndryshimeve përkatëse të shtukturës aksionere të shoqërisë, në rregjistrat e organeve të caktuar nga ligji.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar</b>	<b>Anëtare</b>	<b>Anëtare</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Tomi Frashëri</b>	<b>Ketrin Topçiu</b>	<b>Xhoana Lilaj</b>	<b>Lorenc Bako</b>